FRIEDRICH EBERT STIFTUNG

“Eja të flasim për TATIME!”

Përmbajtja

Çka janë tatimet? 4

Çfarë tatime ekzistojnë? 5

Çfarë mund të jetë norma tatimore? 6

Progresioni tatimor 9

Progresion i drejtpërdrejtë 9

Përse është i nevojshëm tatimi i drejtë? 12

Rritja ekonomike vs. Shpërndarja e të ardhurave dhe ndikimi i tyre ndaj varfërisë dhe pabarazisë 14

Çka janë tatimet?

Tatimet janë të ardhura publike të cilat shteti i siguron përmes tatimpaguesve (personat fizik dhe personat juridik) nga të ardhurat e tyre, fitimi ose pronësia. Njëkohësisht, tatimet janë detyrim obligues i rregulluar me ligj, për të cilin nuk marrim shërbim direkt nga ana e shtetit, por të njëjtat shfrytëzohen për financimin e shpenzimeve publike të domosdoshme për ushtrimin e funksionit të shtetit. Tatimet gjithashtu paraqiten edhe si instrument i rëndësishëm i politikës sociale dhe ekonomike.

Çfarë tatime ekzistojnë?

1

Tatimi mbi të ardhurat *është tatim të cilin e paguajnë të gjithë vendasit dhe të huajt, personat fizik dhe juridik nga fitimi që e realizojnë nga ushtrimi i ndonjë veprimtarie në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

2

Tatimi personal mbi të ardhurat *është tatim të cilin e paguajnë personat fizik nga të ardhurat* totale *të realizuara gjatë një viti, nga burime të ndryshme, në vend apo jashtë vendit. Obligimi tatimor ekziston për të gjithë të ardhurat që realizohen bazuar në rrogën, të ardhura nga aktivitetet e pavarura, të ardhura pronësore dhe të drejtave pronësore (qiraja) ose të drejtat e autorit dhe të drejtat e pronësisë industriale*, të ardhurat kapitale (dividendët, interesi) dhe fitimet kapitale (letrat me vlerë), fitimet nga lojërat e fatit dhe të ardhura tjera të ngjashme.

3

Tatimi i vlerës së shtuar *është tatim i përgjithshëm i cili llogaritet dhe paguhet në secilën fazë të konsumit të mallrave, tregtisë dhe shërbimeve, përveç rasteve të cilat nuk janë të parapara me ligj. Subjekt i tatimit është qarkullimi i* mallrave dhe shërbimeve në vend që realizohet me kompensim nga tatimpaguesi për veprimtarinë e tij ekonomike dhe importit të mallrave.

4

Tatimi mbi pronësinë paguhet nga ana e personave fizik dhe juridik të cilët janë pronarë ose shfrytëzues të patundshmërive, përveç pronësisë e cila me ligj është e liruar nga tatimi. Këtu i numërojmë: Tatimin mbi pronësinë, tatimin mbi trashëgiminë dhe dhuratat dhe tatimin mbi qarkullimin e patundshmërive.

Elementet themelore në procesin e tatimit:

- Objekt tatimor ose objekt i tatimit, prej ku edhe bëhet ndarja e tatimit në tatim mbi të hyrat, tatim i fitimit, tatim mbi pronësinë dhe tatimi mbi konsumin.
- Baza tatimore paraqet shumën e subjektit tatimor mbi të cilin llogaritet tatimi.
- Tatimpagues është bartësi i detyrimit për pagimin e tatimit.
- Norma tatimore paraqet shumën e çdo njësie që zbatohet në bazën tatimore dhe paguhet si tatim (si e tillë caktohet në %).

Çfarë mund të jetë norma tatimore?

Varësisht nga raporti i lëvizjes së normës tatimore dhe ndryshimit të bazës tatimore, norma tatimore mund të jetë:

1. **Normë tatimore proporcionale (ose tatim i "drejtë")** e cila mbetet e njëjtë, pavarësisht ndryshimit të bazës tatimore. Njëkohësisht, vlera absolute e tatimit zmadhohet ose zvogëlohet me zmadhimin ose zvogëlimin e bazës tatimore, derisa raporti relativ mes normës tatimore dhe bazës tatimore mbetet i njëjtë.

2. **Norma tatimore progresive** është ajo e cila ndryshon varësisht nga ndryshimi i madhësisë së bazës tatimore, gjegjësisht rritet ashtu siç rritet baza tatimore. Rezultati mund të jetë rritje absolute ose relative i vlerës së tatimit.

2.1. Normat proporcionale progresive

Baza tatimore	Norma tatimore	Rritje e bazës tatimore	Rritje e normës tatimore
deri 20.000	10%		
prej 20.001 deri 40.000	20%	100%	100%
prej 40.001 deri 60.000	40%	100%	100%

2.2. Normat progresive

Baza tatimore	Norma tatimore	Rritje e bazës tatimore	Rritje e normës tatimore
deri 20.000	10%		
prej 20.001 deri 40.000	25%	100%	150%
prej 40.001 deri 60.000	75%	100%	180%

2.3. Normat regresive progresive

Baza tatimore	Norma tatimore	Rritje e bazës tatimore	Rritje e normës tatimore
deri 20.000	10%		
prej 20.001 deri 40.000	15%	100%	50%
prej 40.001 deri 60.000	20%	100%	33.3%

3

Normat tatimore regresive të cilat ulen me rritjen e bazës tatimore, dominohen nga ana e tatimpaguesve me të ardhura më të larta, që do të thotë tatim jashtëzakonisht i padrejtë

Edhe pse shmangen, veprimi efektiv i disa tatimeve si ai proporcional ("tatim i drejtë") është e njëjtë sikur të zbatohet normë tatimore regresive. Me tatimin proporcional mbi nivel të caktuar, relativisht më tepër ngarkohen personat me të ardhura më të ulëta, ose e kundërta, personat me të ardhura më të larta relativisht janë më pak të ngarkuar (regresion indirekt).

Grafiku 1. Norma tatimore efektive e përgjithshme mbi grupet e ndryshme të të ardhurave, 2017.



Burimi: Ministria e Financave

Grafiku e tregon regresionin gjatë kohës së sistemit tatimor të mëparshëm, gjegjësisht sistemin e "tatimit të drejtë". Efikasiteti i normës tatimore në vazhdimësi rritet për 99% e popullatës, ndërsa te ata 1% me të ardhura më të larta ajo fillon të ulet.

Progresioni tatimor

Progresion i drejtpërdrejtë

1. Progresion global ose i përhershëm

Baza tatimore	Norma tatimore
deri 20.000	10%
prej 20.001 deri 40.000	15%
prej 40.001 deri 60.000	20%

2. Progresion i dyfishtë ose i shumëfishtë

Baza tatimore	Norma tatimore dhe shuma e tatimit
deri 20.000	10% (2.000)
prej 20.001 deri 40.000	2.000 + 15% në shumën mbi 20.000
prej 40.001 deri 60.000	5.000 + 20% në shumën mbi 40.000

E RËNDËSISHME! Është e nevojshme të bëjmë dallimin mes normës tatimore margjinale, mesatare dhe efektive. Ngarkesa reale nga tatimit nuk mund të perceptohet nga raporti mes tatimit të paguar dhe bazës tatimore, por nga raporti mes tatimit të paguar dhe të ardhurave të realizuara, do të thotë, të ardhurat të cilat nuk janë reduktuar nga zbritjet tatimore (lehtësimet tatimore).

Norma tatimore e përshkruar sipas ligjit quhet norma e tatimit ligjor (statutory tax paid – STR). Ajo është nominale dhe rezulton nga bashkëmarrëdhënia e tatimit të paguar (tax rate – TR) dhe bazës tatimore (tax base – TB).

$$STR = \frac{TP}{TB} * 100 = \frac{2.000}{20.000} * 100 = 10\%$$

Kjo normë tatimore paraqitet si lloj i normës tatimore margjinale (MTR – marginal tax rate) tek tatimet progresive, pasi që dallohet nga çdo këst i veçantë. E njëjta zbatohet vetëm për të ardhurat në shumën e shtuar për çdo këst (më të lartë) të ardhshëm, dhe jo për të gjithë të ardhurat.

Baza tatimore	Norma tatimore dhe shuma e tatimit
deri 20.000	10% (2.000)
prej 20.001 deri 40.000	2.000 + 15% në shumën mbi 20.000
prej 40.001 deri 60.000	5.000 + 20% në shumën mbi 40.000

Norma tatimore margjinale e të ardhurave nga kësti i parë deri në 20.000 është 10%, për të ardhmen 15% dhe për të fundit, gjegjësisht kësti më i lartë është 20%. Njëkohësisht, kjo normë tregon rritjen e tatimit ose tatimit të shtuar i cili rezulton nga rritja e bazës tatimore për një njësi.

$$MTR = \frac{\Delta TP}{\Delta TB}$$

- ▲ paraqet tatimin e paguar, ndërsa
- ▲ paraqet bazën tatimore në nivel vjetor

Norma tatimore mesatare (ATR – average tax rate) është normë e cila paraqet marrëdhënien mes tatimit të paguar (TP) dhe bazës tatimor (TB).

$$ATR = \frac{TP}{TB} * 100 = \frac{9.000}{60.000} * 100 = 15\%$$

Norma tatimore efektive (ETR – effective tax rate) është ajo e cila e tregon ngarkesën e vërtetë të tatimpaguesit, pasi që e paraqet marrëdhënien e tatimit të paguar dhe të ardhurat totale të realizuara (TI – total income). Baza tatimore në përgjithësi është më e vogël sesa të ardhurat totale të realizuara për shumën e përjashtimeve dhe zbritjeve, d.m.th. lehtësimet tatimore të tatimpaguesit. Në rast se tatimpaguesi ka zbritje tatimore nga të ardhurat totale në shumë prej 20.000 denarë, norma tatimore efektive është:

$$ETR = \frac{TP}{TI} * 100 = \frac{9.000}{80.000} * 100 = 11.25\%$$

Kjo tregon se norma tatimore efektive është më e ulët se ajo mesatare dhe paraqet efektet pozitive të tatimit progresiv, gjegjësisht ngarkesën reale.

Përse është i nevojshëm tatimi i drejtë?

Tabela 1. Distribuomi i neto të ardhurave në Maqedoni në 2017.

Grupet e të ardhurave	Pragu i grupit (denarë në vit)	Mesatarja e të ardhurave në grup (denarë në vit)
0%-50%	-	103.458
50%-60%	163.715	177.282
60%-70%	191.028	208.023
70%-80%	227.049	251.029
80%-90%	276.789	316.560
90%-95%	373.207	429.761
95%-96%	509.328	537.109
96%-97%	568.189	607.026
97%-98%	653.102	716.711
98%-99%	795.565	941.309
99%-100%	1.152.118	3.310.790

Burimi: Ministria e Financave

Sipas të dhënave nga Ministria e Financave nga viti 2017, Maqedonia e Veriut ballafaqohet me shkallë të lartë të pabarazisë sociale dhe varfërisë. Të dhënat e fundit të publikuara nga Enti Shtetëror Statistikor tregojnë që 22.2% është shkalla e varfërisë. Deri sa gjysma e popullsisë ka të ardhura mesatare në nivel vjetor afër 100.000 denarë (tabela 1), ndërsa personat me të ardhura më të larta 1% në shtet përfitojnë 14.4% nga të ardhurat totale me të cilat disponon shteti.

Grafiku 2. Trekëndësh i pabarazisë, varfërisë, shpërndarjes të të ardhurave dhe rritjeve

Rritja ekonomike vs. Shpërndarja e të ardhurave dhe ndikimi i tyre ndaj varfërisë dhe pabarazisë

Me rritjen ekonomike ndikohet ndaj varfërisë dhe pabarazisë. Raporti mes rritjes dhe pabarazisë varet nga shkalla dhe karakteri i rritjes, i cili i referohet implikimeve distributive që ka. Mirëpo, pabarazia nuk është rezultati final i rritjes ekonomike, por megjithatë luan rol kyç në përcaktimin e shkallës së mëtutjeshme dhe drejtimit të rritjes.

Për realizimin e rezultateve të dukshme në aspektin e luftës ndaj varfërisë dhe pabarazisë, politikat dhe strategjitë mbi rritjen ekonomike dhe shpërndarjen e të ardhurave patjetër duhet të jenë në pajtim njëra me tjetrën.

Politika efektive për uljen e varfërisë dhe pabarazisë mund të arrihen përmes:

1. Shpërndarjes të pjesës më të lartë me të ardhura më të larta në shoqëri përmes tatimit progresiv.
2. Të rritet aftësia e konsumit përmes ndërhyrjes së shtetit te pjesa me të ardhura më të ulëta (rroga minimale dhe të ardhura minimale adekuate).

Tatimi progresiv kontribuon në:

- Uljen e dallimeve sociale në shoqëri.
- Rritjen e aktivitetit të përgjithshëm të konsumit me ç'rast ndikon pozitivisht ndaj aktivitetit ekonomik.
- Të ardhura publike më të larta, si dhe shërbime publike më të mira dhe më kualitative.
- Ngadalësim i ritmit të rritjes së borxhit publik.
- Ruajtjen e stabilitetit më të madh ekonomik

- Kompensim i efekteve regresive të tatimeve tjera në sistemin tatimorë (tatimet indirekte siç është TVSH-ja).
- Respektimi i parimit të dobisë tatimore..
- Respektimi i parimit mbi aftësinë për të paguar tatimin, tatim i drejtë.

Fondacioni Fridrih Ebert Zyra në Shkup
rr. Borka Taleski 42/6
1000 Shkup
www.fes-skopje.org

Redaktor i broshurës:
Ivana Vuçkova

Dizajn dhe shtyp:
KONTURA

Përkthyes:
Fari Hiseni